

Nr. 2360 Prot.

Durrës, më 17.10.2025

## V E N D I M

Nr. III, datë 17.10 2025

### PËR

**"NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 92, DATË 18.09.2025 TË SENATIT AKADEMIK PËR "MIRATIMIN PARAPRAK TË KRIJIMIT TË "QENDRËS SË STUDIMEVE NDËRDISIPLINORE" NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; në mbështetje të Statutit të UAMD-së, neni 5, pika f; në Rregulloren e UAMD-së; në Vendimin nr. 92, datë 18.09.2025 të Senatit Akademik, referuar kërkesës së Bordit të Administrimit me e-mail, si dhe referuar relacionit të përbashkët të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit dhe Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 2340 prot., datë 16.10.2025 "Relacion për ndryshim në Vendimin Nr. 92, të Senatit Akademik, në funksion të shtesës në strukturën organike për krijimin e "Qendrës së Studimeve Ndërdisciplinore", Senati Akademik,

### V E N D O S I:

1. Miratimin paraparak të një ndryshimi në vendimin nr. 92, datë 18.09.2025 të Senatit Akademik për "Miratimin paraparak të krijimit të "Qendrës së Studimeve Ndërdisciplinore" në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës", sipas specifikimeve në relacionin bashkëlidhur këtij vendimi.
2. "Qendra e Studimeve Ndërdisciplinore" në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, do të funksionojë në nivel institucional dhe do të ketë në përbërje 4 (katër) personel akademik.
3. Ky vendim i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

### K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

